

Në kërkim të Zgjidhjeve për Veriun e Kosovës

Hyrje

Këshilli për Qeverisje Inkluzive (CIG) ka organizuar një tryezë të rrumbullakët për përfaqësues të partive politike dhe shoqërisë civile nga Serbia dhe Kosova, duke përfshirë përfaqësues të serbëve të Kosovës, për të diskutuar krizën në veri të Kosovës. Tryeza është mbajtur në Budvë të Malit të Zi prej 5 deri më 7 tetor të vitit 2012. Dita e parë e debatit ka përfshirë vetëm përfaqësuesit shqiptarë dhe serbë nga Kosova. Përfaqësuesit nga Serbia i janë bashkuar diskutimit në ditën e dytë dhe të tretë. Qëllimi i tryezës ka qenë kërkimi i zgjidhjeve në kuadër të zgjidhjeve rajonale për çështjen e veriut dhe marrëdhëniet mes Beogradit e Prishtinës.

Kjo tryezë është pjesë e një projekti të financuar nga Departamenti Federal Zvicrran i Punëve të Jashtme.

Pjesëmarrësit kanë shprehur brengën e tyre se asnjë palë nuk ka vizion për zgjidhjen e krizës së veriut. Në ndërkohë, kriza është duke penguar zhvillimin ekonomik dhe politik të Kosovës dhe Serbisë. Ajo gjithashtu ndikon në jetën e përditshmë të atyre që jetojnë atje, si dhe shpenzon burimet politike e financiare të komunitetit ndërkombëtar. Së këndejmi, nga një zgjidhje do të përfitonin të katër palët e involvuara në këtë krizë në një apo mënyrë tjetër.

Beogradi insiston se institucionet e Kosovës nuk duhet të operojnë në veri përderisa Prishtina mendon se zgjidhja duhet të bazohet në planin e Ahtisaarit. Disa zgjidhje të mesme – autonomia, statusi special, Ahtisaari plus – janë propozuar nga organizata të ndryshme të shoqërisë civile dhe diplomatë ndërkombëtarë, edhe pse shumë pak detaje janë prezantuar. Mirëpo qeveritë në Prishtinë dhe Beograd nuk kanë treguar asnjë gatishmëri që t'i marrin parasysh opsionet që shkojnë përtej ruajtjes së institucioneve të Serbisë apo përtej implementimit të planit të Ahtisaarit. Të dyja qeveritë thonë se zgjidhja duhet të jetë në pajtim me kushtetutat e tyre, një synim ky i pamundshëm.

Komuniteti ndërkombëtar është kyç, nëse jo më kryesori, për zgjidhjen e krizës. Përvoja e kaluar ka treguar se Beogradi e Prishtina nuk ndërmarrin hapa të fuqishëm dhe jopopullor pa trysinë e fuqishme ndërkombëtare. Nuk ekziston as edhe një precedent kur Beogradi e Prishtina kanë arritur marrëveshje si të pavarrura apo duke bashkëpunuar vullnetarisht. Për këtë arsye, disa nga pjesëmarrësit në tryezë kanë thënë se komuniteti ndërkombëtar duhet ta drejtojë procesin e gjetjes së zgjidhjes për veriun.

Pjesa e mëposhtme është një përmbledhje e diskutimit në këtë tryezë. Me qëllim të inkurajimit të diskutimit sa më të hapur, në raport nuk përmenden emrat specifik të folësve dhe CIG u kërkon

mirëkuptim atyre të cilëve mendimet apo komentet nuk u janë paraqitur në tërësinë e tyre në këtë raport të shkurtër. Pjesëmarrësit kanë marrë pjesë në kapacitetin e tyre personal dhe pozicionet e tyre jodomosdoshmërisht reflektojnë pozicionet e organizatave të cilat ata i përfaqësojnë.

Parakushtet për dialog

Një numër i pjesëmarrësve serbë kanë thënë se Beogradi nuk do të pajtohej të dorëzonte pushtetin e tanishëm në veri – siç janë institucionet komunale serbe, gjyqësori, edukimi etj. – dhe kështu t’i lejojnë Prishtinës t’a vendosë autoritetin e saj aty. Disa kanë thënë se është shumë pak e mundshme që Beogradi do të nënshkruajë marrëveshje me Prishtinën, pasi që një gjë e tillë do të nënkuptonte njohjen e legjitimitetit të pavarësisë së Kosovës dhe do të bënte që disa ta shohin atë si njohje të pavarësisë. Megjithatë, shumë prej pjesëmarrësve kanë theksuar se Beogradi tashmë e ka nënshkruar marrëveshjen mbi Menaxhimin e Integruar të Kufirit/Pikes Kufitare (IBM) me Prishtinën.

Një numër i folësve kanë thënë se veriu duhet të definohet në terma gjeografik, legal e politik dhe se ai duhet të ketë fuqi substanciale politike e ekonomike, pavarësisht asaj se a do të mbetet brenda territorit të Serbisë apo Kosovës. Shumë prej pjesëmarrësve e kanë definuar konfliktin si mosmarrëveshje për territor mes dy shteteve, e jo si çështje e të drejtave të njeriut. “Kjo mosmarrëveshje nuk është për të drejtat e njerëzve, është për territor”.

Sipas disa pjesëmarrësve, një udhëheqësi në veri e njohur nga të gjitha palët është parakusht për dialog. Përderisa katër kryetarët e tanishëm të komunave kanë legjitimitet bazuar në votat që kanë marrë në zgjedhjet lokale serbe, Prishtina dhe komuniteti ndërkombëtar nuk i njohin ato. Për më shumë, dy nga kryetarët e komunave dhe administratat komunale janë “jolegjitime” dhe “ilegale” jo vetëm sipas ligjeve të Kosovës, por edhe sipas atyre të Serbisë. Ata janë zgjedhur në zgjedhje që nuk njihen nga institucionet nacionale të Serbisë. Disa komuna e kanë injoruar vendimin e Serbisë për të mos organizuar zgjedhje lokale në Kosovë duke i organizuar ato vetë. Një numër i folësve kanë thënë se pavarësisht legjitimitetit që buron nga një palë zgjedhje, kryetarët e komunave nuk kanë shumë fuqi ekzekutive. “Njerëz tjerë kontrollojnë situatën në veri”. Njerëzit me pushtet ka pak gjasa ta dorëzojnë lehtë atë pasi që i frigohen humbjes së përfitimeve dhe privilegjeve. Pjesëmarrësit kanë diskutuar mënyrat se si të bëhen udhëheqësitë e komunave të pranueshme për të gjitha palët. Para arritjes së një zgjidhjeje të qëndrueshme, disa kanë propozuar që një organizatë që ka qëndrim neutral ndaj statusit, sic është OSBE-ja, do të mund të organizonte zgjedhje neutral lokale në veri. Një pjesëmarrës ka propozuar se një palë zgjedhje të tilla mund të organizohen sipas ligjeve të Kosovës e të cilat për këtë rast do të quheshin “rregullat e OSBE-së”.

Përmirësimi i sigurisë në veri poashtu është konsideruar si një parakusht. Disa kanë propozuar që KFOR-i dhe EULEX-i do të duhej të rrisnin edhe më tej përpjekjet e tyre për luftimin e krimit të organizuar dhe për përmirësimin e sigurisë. Heqja e barrikadave mbetet çështje e pazgjidhur, dhe shume nga pjesëmarrësit kanë thënë se serbët në veri ende i frigohen ndonjë intervenimi të policisë speciale të Kosovës, prandaj edhe janë kundër heqjes së barrikadave. Një numër i pjesëmarrësve, si serbë ashtu edhe shqiptarë, kanë bërë thirrje për heqjen e menjëhershme të të gjitha barrikadave dhe bllokadave në rrugë. Një pjesëmarrës ka thënë se qeveria e Kosovës dhe akterët tjerë duhet të premtojnë se nuk do të ndërmarrin hapa të njëanshëm, duke përdorur dhunë

në veri. Megjithatë, një pjesëmarrës nga Kosova ka thënë se edhe pse Prishtina nuk mendon të ushtrojë dhunë atje, ajo nuk do të pajtohet që t'i hiqet e drejta e intervenimit në territorit e saj.

Disa pjesëmarrës kanë thënë se njerëzit në veri nuk janë të kënaqur me performancën e policisë së Kosovës dhe EULEX-it në veri sa i përket luftimit të krimit të organizuar. Emisioni “Insider” i televizionit serb B92 i quajtur “Hajnia patriotike”, e që hulumton krimin e organizuar në Kosovë, sipas një pjesëmarrësi serb nga Kosova, ka kontribuar më shumë në luftën kundër krimit se sa të gjitha institucionet e sigurisë bashkë. Në tryezë ka ekzistuar pothuajse një konsensus se Beogradi dhe Prishtina duhet ta bëjnë publike shumën e ndihmës financiare që i japin veriut.

Dialog në dy nivele

Një numër i pjesëmarrësve kanë thënë se ekziston nevoja për një dialog simultan në dy nivele për veriun: njëri mes Prishtinës dhe serbëve në veri; dhe tjetri mes Prishtinës dhe Beogradit. I pari ka përkrahjen e të gjitha partive parlamentare të Kosovës, por kundërshtohet nga serbët në veri dhe nga Beogradi. Dialogu i dytë përkrahet nga Beogradi dhe serbët në veri por kundërshtohet nga një numër i partive të Kosovës, e sidomos nga Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Levizja Vetëvendosje. Komuniteti ndërkombëtar mbështet të dyja llojet e dialogut.

Disa nga pjesëmarrësit kanë thënë se çështja e veriut nuk është urgjente dhe se palët nuk duhet të shpejtojnë shumë për të gjetur një zgjidhje. Sipas disa serbëve nga veriu, serbët në veri kanë frikë legjitime dhe atyre duhet tu jepet më shumë kohë për ti marrë parasysh opsionet e ndryshme para fillimit të procesit. Disa kanë thënë se frigohen që dialogu i ardhshëm për veriun do të dominohet nga interesat e Beogradit e Prishtinës, dhe jo edhe aq nga interesat e atyre që jetojnë atje. Ata i kanë bërë thirrje komunitetit ndërkombëtar që të kenë biseda më të shpeshta me përfaqësuesit e katër komunave veriore dhe me njerëz tjerë në veri që t'i kuptojnë më mirë pritjet e tyre si dhe frikën që kanë. Serbët në veri janë të frikësuar se në rast të integritetit në Kosovë, drejtësia arbitrare do të zbatohet ndaj tyre nga gjykatat e Kosovës; ata frigohen se do të humbin përfitimet dhe privilegjet që vijnë nga Beogradi; ata frigohen nga represaliet kundër tyre nga ana e shqiptarëve.

Gjatë diskutimit, pjesëmarrësit kanë qenë të ndarë në vija etnike mbi pothuajse secilën çështje përveç asaj se për kë po punon më shumë koha, për Serbinë apo për Kosovën. Një numër i folësve shqiptarë e serbë kanë thënë se sa më gjatë që çështja të mbetet e pazgjidhur, veriu do të duket më serb. Një grup tjetër i serbëve dhe shqiptarëve kanë thënë se koha po punon në favor të Kosovës sepse pozita e veriut është duke u dobësuar dita ditës si pasojë e marrëveshjeve të arritura mes Beogradit e Prishtinës. “Implementimi i IBM-së në fakt do të zgjidhte çështjet territoriale; kriza do të shëndrrohet në temë të të drejtave të njeriut”, kanë thënë një numër i pjesëmarrësve. Implementimi i IBM-së shënon fillimin e gatishmërisë së Serbisë për të lëshuar pe nga pretendimet territoriale kundrejt Kosovës, me ç'rast veriu do të humbte një pjesë të madhe të mundësisë për të ushtruar tryzni. “Ky është një sqarim territorial për Kosovën dhe Serbinë. Në fakt, IBM-ja do të zgjidhë çështjen e kufirit”, ka thënë një pjesëmarrës. Grupi i tretë ka thënë se vonesa nuk shkon as në të mirë të Kosovës e as të Serbisë e as shumicës së popullsisë në veri. “Mirepo vonesa i shkon për shtati një grupi të njerëzve të cilët përfitojnë financiarisht e politikisht nga kjo krizë”, ka thënë një folës serb. Disa nga pjesëmarrësit kanë thënë se politikanët në Beograd e Prishtinë gjithashtu përfitojnë nga kriza. Po të mos ishte veriu, kanë

thënë disa, ata do të duhej të merreshin me çështje shumë më të vështira siç janë korrupsioni, në të cilin, sipas disave nga pjesëmarrësit, vetë ata janë të involvuar. “Kjo krizë u shkon për shtati të gjithë politikanëve, gjithandë”, ka përfunduar njëri nga folësit.

Disa serbë nga jugu i Kosovës kanë thënë se Beogradi, Prishtina, dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të kërkojnë mënyra për të përkrahur shumë njerëz jopolitik në veri, ashtu siç kanë bërë edhe në jug. Ata poashtu kanë thënë se Beogradi mbetet faktor kyç jo vetëm sa i përket serbëve në veri por edhe për serbët në jug. Beogradi mund të ndihmojë shumë në akomodimin e serbëve në jug. Këtë mund ta bëjë edhe Prishtina poashtu. Një pjesëmarrës ka thënë se me qëllim të largimit të frikës që kanë serbët e veriut nga integrimi, qeveria e Kosovës duhet të bëjë më shumë në jug. Ai ka propozuar që serbëve tu jepet e drejta e mbajtjes së ulëseve të garantuara në parlament, të vazhdohet me transferimin e autoritetit në administratën lokale me shumicë serbe dhe një implementim strikt të ligjeve që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhës serbe në administratë.

Disa nga pjesëmarrësit kanë propozuar një qasje më të ngadalshme: hapi i parë do të mund ishte heqja e barrikadave; caktimi i serbëve si zyrtarë doganor; organizimi i zgjedhjeve lokale “neutrale” në kuptimin legal të fjalës; vendosja e institucioneve të vetëqeverisjes lokale; përmirësimi i sigurisë; përmirësimi i standardit të jetës; dhe vetëm pastaj të adresohet çështja e statusit politik të veriut. Një numër i kënaqshëm i pjesëmarrësve besojnë se këta hapa nuk janë të mundur pa arritur së pari një marrëveshje politike mes Beogradit e Prishtinës.

Temat në dialog duhet të përfshijnë kryesisht nevojat e qytetarëve të veriut. Nevojat e përmendura më së shumti kanë qenë siguria, punësimi, luftimi i varfërisë, prurja e më shumë investimeve, dhe përmirësimi i situatës ekonomike. Disa nga pjesëmarrësit kanë thënë se këto janë të njëjtat nevoja që i kanë të gjithë jo vetëm në Kosovë por edhe në rajon e më gjërë. Dhe përkundër të menduarit se zgjidhja e krizës në veri do t’i zgjidhje të gjitha këto çështje, kjo nuk është e vërtetë. Disa nga to, siç janë papunësia dhe mungesa e investimeve ndikohen nga faktorë tjerë. Mirëpo fusha e sigurisë dhe lirisë së lëvizjes do të përmirësohej dukshëm dhe shpejtë në momentin që marrëveshja arrihet dhe fillon të zbatohet.

Pjesëmarrësit janë lutur që të identifikojnë temat për të cilat Prishtina do të mund të fliste me serbët në veri edhe pa praninë e Beogradit. Asnjëra nga temat nuk ka arritur konsensus, as edhe ato që kanë të bëjnë me projekte të vogla infrastrukturore. Shumica e pjesëmarrësve kanë thënë se Prishtina do të mund të fliste me serbët në veri rreth mbledhjes së plehrave, një problem ky i madh në veri, por jo edhe për temat tjera. Megjithatë, disa pjesëmarrës të Kosovës kanë thënë se Prishtina nuk është aq e dëshpëruar sa të flasë më ta vetëm për çështjen e plehrave. Një numër i pjesëmarrësve kanë thënë se duhet gjetur një mënyrë për të depolitizuar këto çështje praktike që kanë rëndësi lokale. Zyrtarët komunal duhet të merren me mbledhjen e plehrave, jo presidentët apo kryeministrat.

Komuniteti ndërkombëtar dhe veri

Asnjë zgjidhje për veriun nuk ka gjasë të arrihet pa Prishtinën dhe Beogradin. Një aktor i tretë i nevojshëm për të arritur një marrëveshje të tillë është komuniteti ndërkombëtar. Komuniteti ndërkombëtar është posacërisht i rëndësishëm për tu garantuar serbëve në veri se nuk do të lejojë

Prishtinën të intervenojë atje përsëri. Megjithatë, disa dyshojnë se komuniteti ndërkombëtar është duke u lodhur nga kjo situatë dhe se nëse asnjë marrëveshje nuk arrihet së shpejti, ai mund të ndalojë përpjekjet e tij për një kohë.

Përveç kësaj, serbët nuk i besojnë SHBA-ve dhe BE-së në të njëjtin nivel si shqiptarët. Insistimi i serbëve për të përfshirë KB-të në bisedat e ardhshme nuk ka gjasë të ndodhë duke marrë parasysh kundërshtimin nga Kosova dhe aktet kryesorë ndërkombëtarë. Së këndejmi, për serbët në Kosovë, inkadrimi i Beogradit në dialog është thelbësor.

Disa pjesëmarrës shqiptarë pranojnë se roli i Beogradit mund të jetë i paevitueshëm në dialog, por vetëm në “bashkëdizajnimin e zgjidhjes, jo në dizajnimin e saj”. Pothuajse të gjithë pjesëmarrësit serbë e shqiptarë kanë thënë se komuniteti ndërkombëtar duhet të marrë iniciativë për të dizajnuar një zgjidhje. “Ne jemi të barrikaduar në pozicionet tona dhe është e vështirë edhe për neve të dalim me propozime me të cilat mund të punohet”.

Komuniteti ndërkombëtar duhet të ushtrojë trysni ndaj Serbisë që t’i mbajë premtimet për implementimin e marrëveshjeve të arritura në Bruksel. Me rëndësi të veçantë është implementimi i marrëveshjes së IBM-së. Disa nga pjesëmarrësit kanë thënë se shpërbërja e strukturave serbe në veri duhet të jetë një parakusht i menjëhershëm për progresin e Serbisë drejt integritetit në BE.

Opinion i publik, implementimi i marrëveshjeve, dhe kompromiset e ardhshme

Shumë politikanë thonë se ata do të kishin bërë më shumë sikur të mos ishte publiku i tyre i cili nuk i përkrah lëvizjet e fuqishme për zgjidhjen e problemeve. Megjithatë, ata nuk janë në gjendje të mbështesin deklaratat e tilla me të dhëna apo sondazhe. Një pjesëmarrës ka thënë se përmirësimi i marrëdhënieve mes Serbisë e Kosovës mund të mos jetë shumë i pranueshëm nga opinion publik, por as korrupsioni e krimi i organizuar nuk janë të pranueshëm dhe politikanët në Serbi e Kosovë janë të përfshirë në të dyjat. Disa kanë thënë se njerëzit në Kosovë dhe Serbi në fakt e shohin realitetin më mirë se politikanët e tyre.

Një pjesëmarrës ka thënë se qeveria e Serbisë ka formuar një ekip për implementimin e marrëveshjeve dhe se ajo shumë shpejtë do të formojë një ekip tjetër për vazhdimin e dialogut me Prishtinën. Në çfarëdo çështje, Beogradi është i pashmangshëm. Disa çështje lokale, siç është uji, mund të diskutohen nga veriu me Prishtinën drejtpërdrejt. Mirëpo disa kanë thënë se njerëzit lokal në veri nuk do të flasin me Prishtinën as për mbledhjen e plehrave sepse çfarëdo çështje shëndrrohet shumë shpejtë në çështje politike. Ata nuk mund të nënshkruajnë asnjë marrëveshje me Prishtinën. Disa tjerë kanë thënë se të zgjedhurit në veri duhet të marrin përgjegjësi dhe t’i zgjidhin çështjet lokale siç janë uji dhe energjia elektrike, dhe mos të presin nga Beogradi e Prishtina që të merren me to.

Dialogu nuk ka alternativë. Përfaqësimi rajonal është i rëndësishëm për zgjidhjen e problemeve. Transparenca është e rëndësishme. Por arritja e marrëveshjeve nuk është e mjaftueshme. Ato duhet të implementohen dhe ato implementohen më lehtë nëse publiku din për to që nga fillimi dhe është i bindur nga qeveria e tyre se marrëveshjet do të përmirësonin jetën e tyre dhe do të zgjidhnin problemet. “Tani ne duhet të merremi edhe me menaxhimin e opinionit publik e edhe

me implementimin”, ka thënë një folës. Dhe nuk është e lehtë të menaxhohet një publik i papunë e i shqetësuar. Mjafton vetëm një shkëndijë që situata të eskalojë në diçka joproductive. Edhe pse qeveritë janë paksa më transparente tani, ka thënë ky folës, komuniteti ndërkombëtar nuk duhet ti lejojë Beogradin e Prishtinën t’i tregojnë publikut interpretimet shpesh të shtrembëruara rreth marrëveshjeve. “Sponsorizuesi i dialogut duhet të jetë më strikt dhe kur palët nuk e thonë të vërtetën këtë duhet ta bëjë sponsorizuesi i dialogut”.

Këto diskutime duhet të gjenerojnë ide. “Ne kemi nevojë të pajtohemi për ate se çka është e përbashkët për Beogradin, Prishtinën dhe veriun”, ka thënë një folës. Ulja e tensioneve, për shembull, është në interes të përbashkët. Njerëzit duhet të kuptojnë se veriu i Kosovës për Prishtinën është obligim dhe përgjegjësi sepse është pjesë e territorit të saj. Por ata gjithashtu kuptojnë se Serbia dhe serbët në veri operojnë bazuar në besimin se Kosova nuk është shtet i pavarur. Serbia është duke ngelur prapa në raport me ndryshimet dhe realitetin, ka përfunduar një folës. Por të dyja palët duhet ta shohin realitetin më mirë.

Kompromiset janë të nevojshme për të përmirësuar situatën. Të dyja palët duhet të jenë më të gatshme të arrijnë kompromis dhe nëse mbesin të fortifikuara në pozicionet e tyre nuk do të arrijnë larg. Një folës ka thënë se integrimi i plotë i veriut në sistemin e Kosovës është i pamundur. “Edhe nëse Beogradi pajtohet me këtë, serbët e veriut nuk do të pajtohen. Neve na duhet një kompromis i arritshëm”. Folësi gjithashtu ka thënë se politikanët duhet t’ia tregojnë publikut të tyre të vërtetën, se kompromiset e tyre nuk janë zgjedhje por domosdoshmëri.

Një folës ka thënë se presidenti serb Tomislav Nikolic është i përgatitur të marrë përgjegjësi për negociatat me Prishtinën. Beogradi do të angazhohet në këtë proces dhe do të veprojë me përgjegjësi dhe transparencë, por ka tërhequr vërejtjen se veprimet “e njëanshme” do ta devijojnë procesin. Por disa pjesëmarrës kanë thënë se përderisa presidenti Nikolic thotë se “Kosova është Serbi”, kjo do të thotë se ai nuk është i gatshëm të negociojë. Megjithatë dialogu nuk ka alternativë, dhe është më mirë që ai të ndodhë para konfliktit se sa pas tij.

Opsionet për veriun

Akterët dhe organizatat ndërkombëtare, përfshirë edhe ato të cilat nuk e njohin pavarësinë e Kosovës sic janë OSBE-ja apo disa vende të BE-së e shohin Kosovën si një territor të bashkuar. Së fundi, BE-ja ka kërkuar që të respektohet integriteti territorial i Kosovës. Ata e përkrahin një zgjidhje e cila mban veriun brenda Kosovës. Disa shtete poashtu kanë kërkuar që Beogradi t’i shpërbëjë dhe ta ndalojë financimin e strukturave paralele serbe në veri. Por zyrtarët serbë dhe serbët në veri thonë se vendosja e autoritetit të Kosovës atje i tejkalon të gjitha limitet. Ata poashtu mendojnë se ligjet serbe duhet të vazhdojnë të implementohen në veri.

Disa pjesëmarrës kanë thënë se vetëm zgjedhjet e bazuara në ligjet e Kosovës do të ishin të pranueshme për Prishtinën. Ata kanë thënë se një kombinim potencial i legjislacionit, i cili është sugjeruar nga disa, është poashtu i papranueshëm. OSBE-ja mund të organizojë zgjedhje por vetëm në pajtim me ligjet e Kosovës. Megjithatë, këta pjesëmarrës kanë thënë se ka hapësirë për koncesione në lidhje me institucionet serbe të qeverisjes në veri, por se procesi duhet të jetë i tillë që të rezultojë me shpërbërjen e këtyre institucioneve. Por disa tjerë kanë thënë se serbët në veri nuk do të pranonin zgjedhjet të bazuara në ligjet e Kosovës. As Beogradi e as Prishtina nuk

mërziten se kush i organizon ato; ajo për çka mërziten ata është se në kuadër të cilit ligj organizohen ato. Veriu e ka bojkotuar regjistrimin e popullsisë të organizuar nga institucionet e Kosovës dhe as Beogradi nuk e ka njohur atë, prandaj do të ishte e vështirë të krijohen lista të besueshme elektorale.

Disa kanë thënë se pjesëmarrja e serbëve në veri në institucionet e Kosovës është në favor të tyre, pasi që institucionet e tyre nuk funksionojnë në mënyrë efektive dhe kanë legjitimitet të kufizuar.

Një pjesëmarrës ka thënë se disa nga opsionet përfshijnë autonominë rajonale, vetëqeverisje të përkohshme me qëllim të integritetit, dhe një formë të vetëqeverisjes lokale të udhëhequr nga ndërkombëtarët për disa vite të caktuara. Një pjesëmarrës tjetër ka thënë se një nivel i autonomisë, por jo autonomi rajonale, është e mundur përmes “një leximi kreativ të planit të Ahtisaarit”. Ai ka thënë se ndarja nuk është opsion dhe se Serbia e Kosova nuk janë në pozitë të vendosin kushte. Ai ka parashikuar se zgjidhja do të ishte një kompromis: ky kompromis do të bazohet në planin e Ahtisaarit por do të ofrojë një nivel të caktuar të autonomisë për serbët në veri. Një kompenzim për koncesionet e e Prishtinës do të jetë implementimi hap pas hapi i IBM-së.

Autonomia rajonale është një koncept i gjërë, por në esencë katër komunat do të operonin në pajtim me ligjet e Kosovës por do të kishin parlamentin e tyre dhe një administratë të përkohshme të mbikëqyrur. Kjo do të shërbente si një fazë e ndërmjetme për ta përgatitur terrenin për integrimin e veriut në sistemin e Kosovës. Një folës ka shpjeguar se ligjet e Kosovës, përfshirë edhe ligjet zgjedhore, do të shfrytëzoheshin në vendosjen e autonomisë. Cfarëdo forme që do të marrë aranzhimi për veriun, ajo sipas një pjesëmarrësi nuk duhet ta rrezikojë funksionalitetin e Kosovës dhe sistemit të saj të qeverisë.

Një vetëqeverisje e përkohshme do të përfshinte implementimin e ligjeve të Serbisë, por me ndërmjetësimin ndërkombëtar, ligjet e Kosovës do të prezantoheshin dhe implementoheshin gradualisht. Në esencë, kjo do të përfshinte legalizimin e institucioneve ekzistuese në veri përmes një procesi. Një opsion tjetër është që vetëqeverisja lokale në veri të udhëhiqet nga një zyrtar ndërkombëtar me kryetarët e komunave të zgjedhur nga popullata për një periudhë tranzitore derisa palët të pajtohen për një zgjidhje afatgjate. Një tjetër pjesëmarrës ka thënë se çfarëdo që të jetë opsioni, qeverisja në veri duhet të jetë qeverisje përfaqësuese.

Pjesëmarrësi ka thënë se politikanët duhet t'i shqyrtojnë të gjitha opsionet, të kenë një debat racional dhe të dalin me konkluzione. Ai ka thënë se ekziston një opsion i katërt, i ashtuquajtur i opsioni gjerman, i cili bën thirrje për shpërbërjen e institucioneve paralele dhe organizimin e zgjedhjeve të bazuara në ligjet e Kosovës.

Por sa janë të gatshëm Prishtina dhe Beogradi për kompromis? Qeveria e Serbisë nuk është duke vrapuar pas marrjes së datës së anëtarësimit me aq energji sa qeveria e kaluar. Dhe si për çdo qeveri të re, edhe për këtë duhet kohë që gjërat të fillojnë të ecin. IBM-ja është një marrëveshje kyçe, në esencë është demarkacion i kufirit pa zgjidhjen e çështjes së statusit, por implementimi i saj sipas disa pjesëmarrësve është i rëndësishëm për progres në drejtim të integritetit në BE.

Konkluzionet dhe rekomandimet

Nje numër i konkluzioneve e rekomandimeve kane dalë nga kjo tryezë e rrumbullakët. Ato janë propozuar nga individë apo grupe të individëve, por nuk janë të bazuara në konsensus.

- Një numër i pjesëmarrësve kanë propozuar dialog në dy nivele për veriun: një mes Prishtinës dhe serbëve të veriut, dhe një mes Prishtinës e Beogradit. I pari do të adresonte çështjet dhe mosmarrëveshjet lokale në veri; i dyti do të adresonte marrëdhëniet dhe mosmarrëveshjet mes Beogradit e Prishtinës, përfshirë edhe veriun.
- Ulja e tensioneve duhet të jetë prioritet i të gjitha palëve.
- Një numër i vogël i çështjeve mund të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejt mes institucioneve të Kosovës dhe udhëheqësve serbë në veri pa përfshirjen e Beogradit por ato çështje që mund të diskutohen duhet së pari të depolitizohen (mbledhja e plehrave, përmirësimi i infrastrukturës, menaxhimi i ujërave etj.)
- Vonesa në zgjidhjen e krizës nuk i shkon për shtati Kosovës, Serbisë apo serbëve të veriut. Vonesa megjithatë i konvenon një numri grupesh të krimit të organizuar dhe disa politikanëve të caktuar. Grupi i parë përfiton financiarisht kurse i dyti gjithmonë ka një rrugëdalje kur janë në telashe me publikun e tyre rreth niveleve rekorde të papunësisë apo korrupsionit në vendet e tyre.
- Komuniteti ndërkombëtar, në veçanti Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara, duhet të marrin një rol më aktiv në dizajnimin e një zgjidhjeje për veriun. Prishtina dhe Beogradi duhet të përfshihen në proces, por është shumë pak e mundshme që të vetëm të dalin me opsione, dhe nëse e bëjnë këtë, atëherë ato nuk do të jenë të pranueshme për njërën palë. Përfshirja e komunitetit ndërkombëtar është e pazëvendësueshme. Megjithatë, komuniteti ndërkombëtar nuk do t'u bëjë presion palëve që ta pranojnë një zgjidhje. Është në interesin si të Serbisë ashtu edhe të Kosovës që të arrijnë një zgjidhje të pranueshme për të dyja palët.
- Qeveritë në Beograd e Prishtinë duhet t'i zgjidhin çështjet që kanë të bëjnë me veriun e Kosovës jo për shkak të trysnisë apo kushtëzimit të BE-së apo SHBA-së por për shkak se një zgjidhje e tillë është e nevojshme që Serbia dhe Kosova të arrijnë progres në disa çështje më të rëndësishme dhe ekzistenciale dhe sepse popullatat kanë nevojë tepër të madhe për zgjidhjen e një liste të gjatë të problemeve kritike. Shumë serbë të Kosovës tregojnë se ata nuk duhet të bëhen pengesë për integrimin e Serbisë në BE.
- Beogradi mund të jetë i paevitueshëm në dialog, por vetëm në “bashkëdizajnimin e zgjidhjes, jo në dizajnimin e saj”.
- Marrëveshjet mes Beogradit e Prishtinës të arritura në Bruksel, përfshirë edhe marrëveshjen e IBM-së, duhet të implementohen të plota dhe menjëherë. Komuniteti ndërkombëtar duhet të ushtrojë tryzni ndaj palëve që marrëveshjet të implementohen. Vonimi në implementim do të dekurajonte palët që të vazhdojnë diskutimet dhe të arrijnë marrëveshje të reja, dhe do t'i jepte kredibilitet argumentit të forcave opozitare në Serbi dhe Kosovë që thonë se dialogu është i panevojshëm.
- Siguria në veri mund të përmirësohet nëse Prishtina premtan se nuk do të intervenojë me forcë dhe nëse serbët në veri heqin të gjitha barrikadat dhe lejojnë levizjen e papenguar të mallrave dhe njerëzve.
- Prishtina dhe Beogradi duhet ta bëjnë publike shumën e fondeve të cilat i janë dhënë veriut të Kosovës. Kjo transparencë është e nevojshme me qëllim të luftimit të krimit dhe korrupsionit. Disa dyshojnë se paratë shpesh janë pranuar nga Beogradi e Prishtina për të

njejtat projekte.

- EULEX-i së bashku me policinë e Kosovës dhe ate të Serbisë duhet të shkëmbejë informata rreth krimit të organizuar në veri. Është e qartë se deri më tani nuk është bërë sa duhet në luftimin e krimit të organizuar në veri.
- Serbët e Kosovës duhet të përfshihen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë – përmes pjesëmarrjes në ekipet negociatore apo përmes konsultimeve të rregullta me udhëheqësit e dialogut – në dialogun mes Beogradit e Prishtinës. Beogradi e Prishtina nuk duhet të harrojnë se veprimet dhe politikat e tyre në veri do të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ata që jetojnë atje. Ky dimenzion njerëzor duhet të merret parasysh nga të gjithë ata që mundohen ta zgjidhin çështjen e veriut.
- Të menduarit për akomodimin e serbëve në veri të Kosovës kërkon që ata të akomodohen në jug. Beogradi duhet ta përkrahë pjesëmarrjen e plotë të serbëve të Kosovës në institucionet e Kosovës.
- Një numër i opsioneve për veriun të dala nga ky takim kanë qenë autonomia rajonale, statusi special, zbatimi “kreativ” i planit të Ahtisaarit dhe vetëqeverisja lokale e udhëhequr nga ndërkombëtarët.
- Një organizatë që është neutrale ndaj statusit, p.sh. OSBE-ja do të mund të kishte një rol në vendosjen e qeverisë lokale në veri të pranueshme për të gjitha palët përmes organizimit të zgjedhjeve lokale në veri. Shumë prej pjesëmarrësve pajtohen se ligji i tanishëm i zgjedhjeve i Kosovës i emëruar si rregulla të OSBE-së për këtë qëllim mund të përdoret për organizimin e zgjedhjeve.
- Shumë politikanë thonë se ata do të kishin bërë më shumë sikur opinionin e tyre publik të mos ishte kaq jopërkrahës për vendimet e guximshme në zgjedhjet e problemeve. Por të tjerë kanë thënë se janë pikërisht politikanët dhe partitë politike ata të cilët janë duke rritur shqetësimin dhe urrejtjen etnike në mënyrë që të mbeten në pushtet.
- Forcat moderatore politike në të dyja anët duhet ta përkrahin njëra tjetrën dhe duhet të mbështeten nga komuniteti ndërkombëtar. Këto forca poashtu duhet të jenë në gjendje t'i përmbushin kërkesat e votuesve të tyre në mënyrë që të kenë sukses. BE-ja duhet ta bëjë më të kushtueshme të qenit radikal.

Lista e Pjesëmarrësve

Ilir Deda, Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave
Ardian Gjini, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
Dukagjin Gorani, Qeveria e Kosovës
Oliver Ivanovic, Iniciativa Qytetare “Serbi, Demokraci, Drejtësi”
Dusan Janjic, Forumi për Marrëdhënie Etnike
Adriatik Kelmendi, TV Koha Vision
Dusan Kozarev, Zyra e Presidentit të Serbisë
Leon Malazogu, Instituti Demokraci për Zhvillim
Petar Miletic, Partia e Pavarrur Liberale
Randjel Nojkic, Lëvizja e Ripërtrirjes Serbe
Veljko Odalovic, Partia Socialiste e Serbisë; Qeveria e Serbisë
Stojanka Petkovic, Rajonet e Bashkuara të Serbisë
Dejan Radenkovic, Partia Socialiste e Serbisë
Nenad Radosavljevic, Rrjeti i TV stacioneve serbe në Kosovë
Naim Rashiti, Grupi Ndërkombëtar i Krizave
Jelena Trivan, Partia Demokratike
Ljubica Vasic, Partia Progresive Serbe
Azem Vllasi, Analist politik
Gordon Bardos, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Shpetim Gashi, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Alex Grigorev, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Arber Kuci, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Lawrence Meredith, Komisioni Evropian
Norbert Ruetsche, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrrës
Talia Wohl, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme i Zvicrrës